



246/3
23.07.2026.



REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI

DREJTORIA E KURRIKULAVE

Nr. 2487 Prot.

Tiranë, më 21/07 /2026

Lënda: Përcillen Vendimet e Senatit Akademik për kriteret dhe kuotat e pranimit për programet e reja të studimit të ciklit të dytë për vitin akademik 2026-2027.

FAKULTETIT TË ARKITEKTURËS DHE URBANISTIKËS
FAKULTETIT TË INXHINIERISË MATEMATIKE DHE TË INXHINIERISË FIZIKE ✓

Senati Akademik i UPT ka marre vendimet për miratimin e kriterëve të pranimit dhe shpërndarjen e kuotave të parashikuara për programet e reja të ciklit të dytë të studimit, të hapura me Urdhërat Nr.307, datë 01.07.2026, "Për hapjen e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "Inxhinieri Kimike" në Fakultetin e Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, në Universitetin Politeknik të Tiranës" dhe Nr.334, datë 06.07.2026, "Për hapjen e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "Arkitekturë Interieri dhe Dizajn" në Fakultetin e Arkitekturës dhe Urbanistikës në Universitetin Politeknik të Tiranës", si më poshtë vijon:

1. Vendimi Nr. 25, datë 10.07.2026 "Për një shtesë të vendimit nr. 02, datë 30.01.2026 "Për miratimin e kriterëve të pranimit, të përditësuara, në programet e ciklit të dytë të studimeve, për vitin akademik 2026 – 2027".
2. Vendimi Nr. 24, datë 10.07.2026 "Për një shtesë të vendimit nr. 06, datë 12.03.2026 "Për kuotat e pranimit për programet e studimit të ciklit të parë, programet e integruara të studimit të ciklit të dytë dhe programet e studimit të ciklit të dytë, për vitin akademik 2026-2027, në Universitetin Politeknik të Tiranës"

Fakultetet të marrin masat për zbatimin e këtyre vendimeve.

Bashkengjitur gjeni Vendimet e Senatit Akademik të UPT Nr.24, datë 10.07.2026 dhe Nr.25, datë 10.07.2026.

Ju falënderojmë për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin,

REKTORI

Prof. Dr. Akli Fundo





REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 2411 Prot.

Tiranë, më 15 / 07 / 2026

V E N D I M

Nr. 24, datë 10.07.2026

P Ë R

NJË SHITESË TË VENDIMIT NR. 06, DATË 12.03.2026 "PËR KUOTAT E PRANIMIT
PËR PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË, PROGRAMET E
INTEGRUARA TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË DHE PROGRAMET E STUDIMIT
TË CIKLIT TË DYTË, PËR VITIN AKADEMIK 2026-2027, NË UNIVERSITETIN
POLITEKNIK TË TIRANËS"

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies, neni 18, pika 2, mbështetur në propozimet e Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike dhe të Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës për kuotat e pranimi për vitin akademik 2026-2027, Senati Akademik në mbledhjen e datës 10.07.2026,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kuotave të pranimi për programin e ri të ciklit të dytë të studimit "Master i Shkencave në Inxhinieri Kimike", në Fakultetin e Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, të Universitetit Politeknik të Tiranës, për vitin akademik 2026-2027.
2. Miratimin e kuotave të pranimi për programin e ri të ciklit të dytë të studimit "Master i Shkencave në Arkitekturë Interieri dhe Dizajn", në Fakultetin e Arkitekturës dhe Urbanistikës, të Universitetit Politeknik të Tiranës, për vitin akademik 2026-2027.
3. Vendimit i bashkëngjiten tabelat e shpërndarjes së kuotave të pranimi sipas kategorive, për këto programe të reja studimi, për vitin akademik 2026-2027.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë,


KRYETARI

Prof. Dr. Akli Fundo

Kuotat e pranimit për programet e reja të studimit, për vitin akademik 2026-2027

Kuotat sipas programit të studimit për kandidatët																
Nr.	IAL	Njësia kryesore	Programi i studimit	Shuma e kuotave	Shqiptarët brenda vendit	Që aplikojnë për program të dytë	Që aplikojnë për transferim studimesh	Të huaj	Me statusin e jetimit	Persona me aftësi të kufizuara	Romë+ballkano egjiptian	Trojet				
												Kosovë	RMV	Mali Zi	Preshevë	Bujanovë
1	Universiteti Politeknik i Tiranës	Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike	Master i Shkencave në Inxhinieri Kimike	30	16	4	0	0	0	0	0	4	2	1	1	1
2		Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës	Master i Shkencave në Arkitekturë Interieri dhe Dizajn	30	25	2	0	0	0	0	0	1	1	1	0	0

Rektori: Prof. Dr. Akli Fundo






REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 2412 Prot.

Tiranë, më 15 /07 /2026

V E N D I M

Nr. 25, datë 10.07.2026

P Ë R

NJË SHITESË TË VENDIMIT NR. 02, DATË 30.01.2026 “PËR MIRATIMIN E
KRITEREVE TË PRANIMIT, TË PËRDITËSUARA, NË PROGRAMET E CIKLIT TË
DYTË TË STUDIMEVE, PËR VITIN AKADEMIK 2026 – 2027”

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 25 dhe neni 74, Statutin e Universitetit Politeknik, neni 9, si dhe në propozimet e Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike dhe të Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës për kriteret e pranimit në programet përkatëse të ciklit të dytë të studimeve, për vitin akademik 2026-2027, Senati Akademik në mbledhjen e datës 10.07.2026,

V E N D O S I:

1. Të miratojë kriteret e pranimit të programit të ri të studimit “Master i Shkencave në Inxhinieri Kimike”, në Fakultetin e Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, të Universitetit Politeknik të Tiranës, për vitin akademik 2026-2027.
2. Të miratojë kriteret e pranimit të programit të ri të studimit “Master i Shkencave në Arkitekturë Interieri dhe Dizajn”, në Fakultetin e Arkitekturës dhe Urbanistikës, të Universitetit Politeknik të Tiranës, për vitin akademik 2026-2027.
3. Vendimit i bashkëngjiten kriteret e pranimit për këto programe të reja të studimit, për vitin akademik 2026-2027.
4. Ngarkohet Drejtoria e Kurrikulave për të shpallur publikisht kriteret e pranimit në faqen zyrtare të UPT dhe në portalin U-Albania.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. Dr. Akli Fundo



REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI

DREJTORIA E KURRIKULAVE

Kriteret e pranimit në programet e reja të studimit, në Fakultetin e Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike dhe Fakultetin e Arkitekturës dhe Urbanistikës, për vitin akademik 2026 – 2027

1. Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike

- Master i Shkencave në Inxhinieri Kimike

janë vendosur këto kriteret:

- Procesi i pranimit dhe regjistrimit të kandidatëve në ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë, "Master i Shkencave në Inxhinieri Kimike", zhvillohet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, duke respektuar udhëzimet e ministrisë përgjegjëse të arsimit, si dhe procedurën e përshkruar në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhenies në UPT.
- Pranimi në Programet e studimit "Master i Shkencave në Inxhinieri Kimike", si për të gjitha programet e ciklit të dytë të studimeve është i mundur për kandidatët që kanë përfunduar të paktën një program studimi të ciklit të parë. Renditja e aplikanteve bëhet në bazë të mesatares së ponderuar të ciklit të parë të studimeve të diplomës bachelor dhe në përputhje me kriteret e tjera të vendosura nga DIK.
- Lejohen të ndjekin këtë program studimi ata kandidatë që zotërojnë një diplomë të ciklit të parë "Bachelor në Inxhinieri Kimike" ose degë të ngjashme me të, në UPT dhe në universitete të tjera të vendit ose të huaja.
- Kandidatët që vijnë nga institucione universitare të tjera duhet të jenë diplomuar në një program të ciklit të parë të licensuar dhe të akredituar. Këta kandidatë mund të plotësojnë kreditet shtesë me një plan vetiak studimi, për lëndët ose modulet përkatëse që mungojnë, të përcaktuar nga Departamenti i Inxhinierisë Kimike.
- Për t'u regjistruar në këtë program studimi kandidatët, të cilët janë diplomuar jashtë vendit duhet të jenë të diplomuar në një program të ciklit të parë të licensuar dhe të akredituar, si dhe duhet të bëjnë njesimin e diplomës në ministrinë përgjegjëse.

2. Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës

- Master i Shkencave në Arkitekturë Interieri dhe Dizajn

janë vendosur këto kriteret:

- Pranimi në programin e studimit të ciklit të dytë "Master i Shkencave në Arkitekturë Interieri dhe Dizajn" është i mundur për çdo kandidat i cili ka përfunduar studimet e ciklit të parë në fushën e Arkitekturës dhe të Dizajnit. Kandidatët që kanë diplomë të ciklit të dytë mund të përfitojnë nga kuotat e dedikuara për program të dytë studimi.
- Kriteri i përgjithshëm i përzgjedhjes dhe renditjes së kandidatëve në këtë program studimi është nota mesatare e ponderuar e viteve të studimit në ciklin Bachelor (ose e të pesta viteve në rastin e programeve të dyta të studimit). Pas analizës së cilësisë së studentëve në hyrje, çdo vit akademik, Departamenti i Arkitekturës mund të propozojë kriteret specifike të cilat miratohen dhe shpallen përpara procesit të përzgjedhjes.